Në një përpjekje të vazhdueshme për të përkrahur decentralizimin fiskal në Shqipëri, Projekti i Planifikimit dhe Qeverisjes Vendore në Shqipëri (PLGP) i financuar nga USAID, paraqiti një dokument politikash mbi decentralizimin fiskal në Shqipëri, duke u përqendruar veçanërisht në gjendjen aktuale të procesit dhe se çfarë mund të bëhet më tej për sa i takon politikë-bërjes? Më konkretisht, dokumenti i politikave, i cili u hartua nga ekspertë në nivel kombëtar e ndërkombëtar, ku dhanë kontribut në punë parapregatitore dhe hartim të dokumentit edhe ekspertë të Co-PLAN, u konceptua më tepër si një instrument për të nisur dialogun mes palëve të interesuara, sesa si një dokument, duke u përqendruar në katër fusha kryesore: **(1)** korniza ligjore; **(2)** struktura administrative territoriale dhe ndarja e shpenzimeve; **(3)** të ardhurat dhe transfertat ndërqeveritare; dhe **(4)** huamarrja vendore. Gjetjet e këtij dokumenti politikash, të cilat mund të shkarkohen nga faqja zyrtare PLGP-së, u diskutuan gjerësisht me autoritetet e qeverisjes qendrore dhe vendore, si dhe me shoqatat kombëtare lokale dhe komunitetin e donatorëve. Komentet dhe propozimet e marra janë përfshirë në draftin final të dokumentit të politikave, i cili u finalizua në shtator të vitit 2012 dhe u diskutua në konferencën e decentralizimit fiskal mbajtur në fillim të tetorit të vitit 2012. Bazuar në gjetjet e dokumentit, dhe të objektivit të përgjithshëm, më 4 tetor 2013 u mbajt konferenca mbi decentralizimin fiskal në Shqipëri, një aktivitet i nivelit të lartë i cili u ndoq nga Kryeministri i Shqipërisë z. Sali Berisha, Ambasadori Amerikan z. Alexander Arvizu, Kryetarë të NJQV-vë partnere të PLGP-së, përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Financave, komunitet të donatorëve që punojnë në qeverisjen vendore dhe OJQ-të. Njësitë e qeverisjes vendore partnere të PLGP-së përfshijnë: Tiranën, Durrësin, Fierin, Lushnjën, Beratin, Kuçovën, Patosin, Vlorën, Sarandën, Elbasanin, Korçën, Vorën, Kamzën dhe komunat e Kasharit e të Paskuqanit.

Studimi identifikonte dhe rekomandonte ndërmarrjen e një sërë veprimevësh të menjëhershme dhe afatgjata, të cilat u fokusuan kryesisht në rishikime dhe kompletime procesesh në lidhje me: **(1)** kornizat ligjore; **(2)** strukturat administrative territoriale dhe ndarjen e shpenzimeve; **(3)** të ardhurat dhe transfertat ndërqeveritare; dhe **(4)** huamarrja vendore.

Gjendja e Rajonalizimit në Shqipëri

Progresi dhe Sfidat Përpara

Co-PLAN, në kuadër të përfshirjes në zbatimin e Programit të Zhvillimit Rajonal për Shqipërinë Veriore dhe kontributit në çështje të rajonalizimit, mori pjesë në një tryezë ndërkombëtare të organizuar nga Ministria e Brendshme. Kjo tryezë, e organizuar në bashkëpunim me Programin e Zhvillimit Rajonal për Shqipërinë Veriore në kuadër të Kryesisë së Komitetit të Ministrave të Këshillave të Evropës, kishte në fokus çështje të rajonalizimit, nisur nga përpjekjet e vazhdueshme, por të pamjaftueshme për të çuar përpara çështjet e zhvillimit rajonal dhe rajonalizimin. Qëllimi i kësaj tryeze ishte që të trajtonte këto çështje përmes një debati mes ekspertësh duke përgatitur një listë me hapat kryesorë për t'u ndërmarrë nga qeveria shqiptare gjatë dialogut politik dhe vendimmarrjes. Disa nga pyetjet e ngritura në tryezë ishin: **(1)** Aktualisht, qarku ka një rol relativisht të vogël në qeverisje, vendore krahasuar me bashkitë dhe komunat, por mund të ketë një rol të rëndësishëm në nxitjen dhe koordinimin zhvillimit rajonal nga lart – poshtë. A do të mbetet qarku me të njëjtat funksione dhe kufinj territorial, apo do të caktohet një rajon i ri? **(2)** Nëse do të përcaktohen rajone të reja, cili mund të jetë lloji i preferuar i rajonalizimit që mund të bëhet në Shqipëri për të përmbushur nevojat e brendshme në zhvillimin ekonomik dhe në decentralizim? **(3)** Si duhet ta lidhë Shqipëria zhvillimin e brendshëm rajonal me zhvillimin rajonal të BE-së dhe politikat e kohezionit? **(4)** Cilat do të jenë implikimet institucionale, ligjore dhe politike të çdo reforme në zhvillimin rajonal dhe rajonalizimin në Shqipëri? **(5)** Si do të ndërveprojnë [në mënyrë reciproke] përpjekjet për rajonalizimin dhe zhvillimin rajonal me procesin e integritimit në Evropë.

Për të mundësuar adresimin dhe përgjigjen e këtyre pyetje, tryeza e rumbullakët e cila u kryesua nga zëvendësministri i Punëve të Brendshme z. Ferdinand Poni, u fokusua në katër temave kryesore: **(1)** Sfidat e decentralizimit dhe rajonalizimit të Shqipërisë nga perspektiva e Kongresit të Autoriteteve Vendore (z.Andreas Kiefer, Sekretari i Përgjithshëm i Kongresit); **(2)** Statusi i "rajonit" dhe mundësitë për përmirësim (z.Besnik Aliqj); **(3)** Roli i "rajonit" në kontekstin e Integritimit Evropian (znj.Grida Duma); **(4)** E ardhmja e Zhvillimit Rajonal dhe e institucioneve të lidhura me të në Shqipëri (z. Daniel Wagner).





Roli dhe Kompetencat e QARKUT dhe Instrumentet e tjera të Zhvillimit Rajonal

Në kuadrin e Programit për Zhvillim Rajonal në Shqipërinë e Veriut, Rudina Toto, Dritan Shutina dhe Prof. Dr. Besnik Aliaj përgatitën një dokument politik të detajuar, ku rishikuan rolin dhe kompetencat e Qarkut dhe institucioneve të tjera mbështetëse të lidhura me Zhvillimin Rajonal. Dokumenti kishte si qëllim nënvizimin e sfidave të shumta me të cilat përballen institucionet e zhvillimit rajonal si dhe vetë procesi në Shqipëri, duke detajuar ndryshimet e nevojshme në politika për tu përballur me këto sfida.

Dokumenti, pjesë e publikimit "Politikëndjekës apo Politikëbërës 2!", ofron një sfond të detajuar të zhvillimit rajonal në Shqipëri, përfshirë një analizë të kuadrit ligjor dhe strategjik, instrumenteve dhe palëve të interesit. Zhvillimi historik, hapësinor dhe social-ekonomik i zhvillimit rajonal shpjegohet në dokument, në kontekstin shqiptar dhe evropian, duke u fokusuar te territori i qarkut, këshillat dhe administrata e qarkut si një pikë lidhëse dhe institucion për qeverisje rajonale dhe zhvillim rajonal. Një analizë gjithëpërfshirëse e procesit dhe pritshmërive, duke marrë parasysh prioritetet e Shqipërisë për integrim në BE, deduktohet nga sfidat kryesore me të cilat përballlet zhvillimi rajonal në Shqipëri. Këto variojnë nga roli ende i papërcaktuar i qarkut si institucion, te kuadri i pamjaftueshëm ligjor dhe strategjik për zhvillim rajonal dhe deri te përpjekjet politike për të përparuar me decentralizimin politik, administrativ dhe fiskal në Shqipëri. Ndryshimet politike që nevojiten për t'u përballur me këto sfida duhet të fokusohen në krijimin e një zhvillimi rajonal më gjithëpërfshirës dhe të integruar. Politika e re duhet të synojë dy objektiva kryesorë: **(1)** të krijojë kushtet ligjore dhe institucionale për ofrimin e shërbimeve cilësore, të qëndrueshme dhe efikase qytetarëve; si dhe **(2)** të nxisë zhvillim rajonal të qëndrueshëm duke forcuar kohezionin socio-ekonomik, rritur konkurrencën ekonomike, si dhe duke ndërtuar një kuadër ligjor dhe institucional gjithëpërfshirës që i përgjigjet sfidave të zhvillimit kombëtar dhe kërkesave të integritimit në BE.

Dialog mes Qyteteve të Evropës Juglindore

Planifikimi Urban dhe Manaxhimi i Tokës mbledhi në një seminar dy ditor 90 pjesëmarrës nga tetë vende të ndryshme të Evropës Juglindore. Në fokus të seminarit ishte modernizimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për përdorimin hapësinor dhe planifikimit tokës në Europën Juglindore. Seminari u organizua nga Instituti i Bankës Botërore, si pjesë e Dialogjeve Qytet-me-Qytet (City-to-City Dialogue / C2C), e cila është një iniciativë si pjesë e programit të Bankës Botërore-Austri Program i Partneritetit Urban, filluar në dhjetor të vitit 2011. Objektivi kryesor i C2C është që të mundësojë një dialog dhe shkëmbim njohurish midis qyteteve.

Seminari, i cili u mbajt në qershor 2012 në mjediset e Universitetit Polis, Tiranë, me mbështetjen e Co-PLAN, priti përfaqësues nga Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia. Mes pjesëmarrësve ishin delegatë nga shoqatat e qeverisjes vendore, 29 qytete partnere, planifikues urbanë, ekspertë vendorë dhe rajonale, delegatët nga agjencitë e qeverisë qendrore dhe institucioneve nga disa prej vendeve pjesëmarrëse etj.

Një nga qëllimet kryesore të këtij seminari ishte që të angazhohen një pjesë e planifikuesve urbane në kërkim dhe diskutim konstruktiv të çështjeve të planifikimit urban të lidhura që mbajnë peng komunitet/ bashkitë nga përshejtimi i zhvillimit ekonomik lokal; dhe nga parandalimi i ndërtimeve masive informale në rajon. Duke pasur parasysh se ishte takimi i parë i një serie takimesh të planifikuara, qëllimi i tij ishte gjithashtu të theksojë ide mbi subjekte të mundshme për impenjime të ardhshme. Secili prej gjashtë sesioneve u çel nga një prezantim nga ekspertët rajonalë apo ndërkombëtarë dhe pastaj kishte një kohë të mjaftueshme për diskutime të asistuar.

Në përfundim, u kuptua se ky format interaktiv i seminarit funksionoi jashtëzakonisht mirë dhe mundësoi arritjen e dy rezultateve shumë të rëndësishme. Së pari, komentet e pjesëmarrësve, sugjerimet e detajuara, ri-konfirmuan konstatimet kryesore të paraqitura në prezantimet e ekspertëve. Së dyti, disa pjesëmarrës bënë një hap më tej duke formuluar një numër të ideve themelore, të cilat edhe nëse nuk ofrojnë zgjidhje specifike për problemet ekzistuese, japin një ndihmesë në thellimin e dialogut.





Diskuto Hapësirën Tënde

Mënyra se si i shohim ne sheshet e qytetit në ditët e sotme në Ballkan me siguri përbën subjekt për të kuptuar se si këto habitate janë duke u transformuar në funksionet dhe rolet për komunitetet, ose sjelljen e një kulturë tjetër në krahasim me të shkuarën. Në Co-PLAN, ne i shohim sheshet e qyteteve si hapësira të hapura për përdorim publik multi-funksional. Ne besojmë se sheshet e qytetit mund të konceptohen si vende/hapësira për të shprehur marrëdhënie kulturore, civile dhe sociale, si pika fokale për diversitetin kulturor dhe integrim; si vende për shprehje demokratike dhe kulturore dhe një stimul jetik për sipërmarrjen dhe zhvillimin kulturor të qyteteve. Përmes projektit *Rijetëzimi i shesheve të qyteteve të Ballkanit*, i cili ka filluar të zbatohet në janar të vitit 2011, ne jemi vazhdimisht të angazhuar në aktivitete të ndryshme në një përpjekje për të transformuar sheshet e qytetit në hapësira të reja, krijuese, të gjalla dhe të përshtatshme për përdorim publik.



Aktiviteti ynë më i fundit, një tryezë e rrumbullakët mbajtur në qershor 2012, u konceptua në formën e një forumi të hapur. Për këtë tryezë të rrumbullakët, ne u ulëm në një hapësirë të hapur të kryeqytetit, në Tiranë - përballë urës tek Ish-Ekspozita Shqipëria Sot dhe ftuam kalimtarë të rastit të na bashkohen në një diskutim të hapur të hapësirave publike. Diskutimi kishte për qëllim të inkurajonte qytetarët të shprehnin idetë e tyre dhe të sugjeronin mënyra të mundshme për rigjallërimin e hapësirave publike. Ata u asistuan nga disa ekspertë në fushën e arkitekturës, planifikimit urban, punës sociale etj. Zgjedhja e vendit nuk ishte rastësi, pasi gjatë vitit të shkuar, së bashku me studentët U_POLIS, Co-PLAN analizoi problematikat kryesore të hapësirave të tilla dhe propozoi disa ide të realizueshme krijuese për një zhvillim të ri të mundshëm të këtyre hapësirave. Qytetarët ishin të gatshëm për t'u bërë pjesë e diskutimeve dhe të shprehnin dëshirat e tyre. Më tej, ata u njohën me një numër skenarësh zhvillimi të përgatitur nga studentët, të cilët treguan mënyra të mundshme për të transformuar zonën publike për të përmbushur sa më mirë nevojat e qytetarëve.



Llogaridhënia Sociale dhe Teknologjia e Informacionit (TIK)

Co-PLAN dhe Bashkia Durrës organizuan më 6 dhjetor 2012, seminarin “Qeveria lokale, qytetarët dhe shoqëria civile në Durrës: Si të përmirësojmë komunikimin, pjesëmarrjen dhe transparencën nëpërmjet përdorimit të teknologjisë”. Seminari u organizua si pjesë e projektit “Auditimi i llogaridhënies sociale në qytetet e Durrësit, Prishtinës, Shkupit, Banja Lukës dhe Sarajevës”, financuar nga Banka Botërore.

Qëllimi i këtij seminari ishte të mbledhte përfaqësues nga Bashkia Durrës, nga grupe të ndryshme shoqërore, nga shoqëria civile, nga biznese, si dhe nga media për të diskutuar në lidhje me skenarë ndërhyrjesh të mundshme për të rritur cilësinë e ofrimit të shërbimeve në qytet për rritjen e nivelit të pjesëmarrjes qytetare në vendimarrje, si dhe transparencës së proceseve, nëpërmjet përdorimit më efektiv të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Skenarët e sugjeruar/zhvilluar përgjatë seminarit u përmbledhën në një raport në trajtë rekomandimesh me synimin për t’u bërë pjesë e Planit Strategjik të Zhvillimit Ekonomik Lokal të qytetit të Durrësit. Disa nga propozimet kryesore të zhvilluara ishin: **(1)** ridizenjimi i sitit zyrtar të bashkisë për të rritur shkallën e informacionit, shërbimeve, dhe transparencës me qytetarët; **(2)** fuqizimi i proceseve me pjesëmarrje, si p.sh., ai i hartimit buxhetor me pjesëmarrje; **(3)** rishikimi i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik të Qytetit.





Huamarrja Vendore dhe Përdorimi Efiçent i saj

Në linjë me angazhimin e Co-PLAN në zbatimin e projektit “Huamarrja e qeverisjes vendore – sfida për ta përdorur në funksion të ndikimit në zhvillimin ekonomik lokal”, u organizua në mjediset e U_POLIS, trajnimi i parë “Huamarrja vendore dhe përdorimi efiçent i saj”. Ky training, i cili u organizua në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, ishte pjesë e një cikli të përbërë nga 3 trajnime.

Trajnimet adresuan specialistët e pushtetit vendor të angazhuar në çështje të përgatitjes dhe ndjekjes së procedurave të aplikimit për kredi, çështje të financave vendore, përgatitjes së studimeve dhe projekteve kapitale etj. Trajnimi preku tema si: kuadri ligjor i huamarrjes së qeverisjes vendore në Shqipëri, aftësimi i stafit për të realizuar procesin e aplikimit për kredi pranë institucioneve financiare, si dhe për të përgatitur projekte të ndryshme të financueshme përmes huave. Pjesëmarrësit u njohën gjithashtu dhe me praktikatat e studimit të mundshmërisë së investimit, analizën financiare dhe forma të tjera të vlerësimit të ndikimit të projektit në zhvillimin ekonomik lokal.

Projekti “Huamarrja e qeverisjes vendore – sfida për ta përdorur në funksion të ndikimit në zhvillimin ekonomik lokal” u financua nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), dhe kishte për qëllim që përmes trajnimeve të ngrinte dhe të forconte kapacitetet vendore në çështje të huamarrjes vendore dhe të krijonte modele të reja të përdorimit të huasë në nivelin vendor të qeverisjes.





DAS Ph. T. Reeker viziton Co-PLAN dhe POLIS

Stacioni i parë i autobuzit me shishe plastike tërhoqi vëmendjen e Ndhmës-Sekretarit të Departamentit të Shtetit Amerikan, Z. Philip Reeker, i cili u ndal në Kashar për të vizituar grupin e punës nga Co-PLAN dhe Universiteti POLIS.

Funksionari i lartë amerikan, i shoqëruar nga përfaqësues të Ambasadës Amerikane, Tiranë, theksoi se një pjesëmarrje më e lartë qytetare përshpejton ndryshimet për mirë në komunitet. Ai, gjithashtu, vuri në dukje se format e pjesëmarrjes qytetare mund të variojnë sipas mundësive, si p.sh. bashkëpunimi me drejtuesit vendorë, këshillat vendorë, deputetët, apo me këdo mundet për të sjellë ndryshime të mira në komunitet.

Stacioni i autobuzit me shishe plastike në Kashar, përveçse një shembulli konkret bashkëpunimi të komunitetit me drejtues vendorë, ofron një shembull shumë të mirë të dizajnit kreativ dhe riciklimit për një mjedis më të pastër. Për ndërtimin e këtij stacioni u përdorën rreth 10,000 shishe të vogla plastike të ricikluara në pesë muaj, si dhe një skuadër e përbërë nga arkitektë, planifikues urban, ekspertë të art-dizajnit si dhe shumë studentë.

Shishja e parë e këtij stacioni të veçantë u vendos nga Ndhmës-Sekretari i Departamentit të Shtetit Amerikan, Z. Philip Reeker, gjatë vizitës së tij në Shqipëri, më 8 shtator 2012, i cili vizitoi dhe përshëndeti grupin e punës.

Nisur nga origjinaliteti në dizajn dhe qasje, ky projekt nuk e ka pasur të lehtë të pranohet në nivel lokal, pavarësisht mbështetjes së vazhduar të Komunës Kashar. Megjithatë, Co-PLAN dhe Universiteti POLIS janë të vendosur të vijojnë me eksperimente të ngjashme në nivel lokal në të mirë të komunitetit dhe mjedisit ku jetojmë, dhe gjejnë rastin të ftojnë për bashkëpunim partnerë të lëvizjes mjedisore në vend për të vazhduar me sipërmarrje të tjera të suksesshme.



ACT NOW – Bëj të Dëgjohet Zëri Yt!

Ambasada Amerikane në Tiranë, nën kujdestarinë e veçantë të Ambasadorit z. Alexander Arvizu, prezantoi nismën e saj më të re ACT NOW – Bëj të dëgjohet zëri yt!. Nisma kërkon të zgjojë ndërgjegjen qytetare shqiptare për të mos mbetur apatike ndaj ngjarjeve që prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë jetën e tyre. Z. Ambasador theksoi rëndësinë e njohjes nga qytetari të të drejtave dhe përgjegjësisë të tij, si dhe pjesëmarrjen e tij aktive në ‘qytetbërje’ dhe vendimarrje. Në formën e 12 pikave, z. Arvizu u erdhi në ndihmë qytetarëve me ide praktike se si ata mund të përfshihen e të dëgohen në çështje të arsimit, mjedisit, qeverisjes, dhe shëndetësisë. Nëpërmjet thirrjes “Bëj të dëgjohet zëri yt”, Ambasadori Arvizu i ftoi qytetarët dhe shoqërinë civile të bëhen pjesë e lëvizjeve që sjellin ndryshim. Kjo e fundit përqëndrohet në 4 tema kryesore me 12 pikat jetësore, thelbësore, njerëzore që duhet të pretendojë e ku duhet të kontribuojë çdo shqiptar: arsimi, mjedisi, qeverisja, shëndetësia.

Co-PLAN iu bashkua thirrjes së Ambasadës Amerikane në Tiranë “ACT NOW – Bëj të dëgjohet zëri yt”, duke filluar nga pjesëmarrja në një panair të dedikuar, ku ndau me publikun numër publikimesh me fokus qytetarin përkatësisht në fushën e planifikimit të territorit, efikasitetit të energjisë, mjedisit dhe financave publike, dhe realizoi një shfaqje teatrale për fëmijë me temë ‘qytetbërjen’ dhe performancën teatrale ‘POLI(TICIAN)S’, të realizuar dhe të vënë në skenë nga studentët e Universitetit POLIS.





Javët e Arkitekturës në Tiranë

Sikurse pritej që nga viti 2011, Javët e Arkitekturës në Tiranë, mbajtur në shtator – tetor 2012, për nga dimensionimi i saj ndërkombëtar dhe intensiteti i aktiviteteve të organizuara si dhe njohurive të shkëmbyera, shënoi dhe pikën kulmore të kalendarit të aktiviteteve të U_POIIS për vitin 2012. Gjatë muajve shtator-tetor 2012, Tirana u shndërrua në një mikëpritëse të denjë të ekspertëve ndërkombëtarë, profesionistëve të fushës së arkitekturës, planifikimit urban e dizajnit, duke e kthyer qytetin në një shfaqje të gjallë për performancat dhe aktivitetet e planifikuara, si pjesë e katër blloqeve përbërëse të Javëve të Arkitekturës në Tiranë, përkatësisht: arkitekturë, art & dizajn, aktivitete publike, dhe seminarë ndërkombëtarë.

Qëllimi i Javëve të Arkitekturës në Tiranë ishte të promovonte shkëmbim ndërkombëtar të njohurive mes profesionistëve dhe rritje të interesit publik në arkitekturë, art e dizajn, si dhe disiplina të lidhura ngushtë me zhvillimet bashkëkohore të qytetit.

Aktivitete Arkitekturore

Swiss Positions - 33 qasje të ndërtimit të qëndrueshëm – një ekspozitë lëvizëse, koleksion i 33 projekteve kyç nga industria e ndërtimit në Zvicër të njëzet viteve të shkuara, të cilat kishin të përbashkët temën e zhvillimit të qëndrueshëm. Arkitektura dhe inxhinieria zvicerane gëzojnë një reputacion të shkëlqyer dhe vizibilitet të lartë jo vetëm për nga cilësia e ekspertizës teknike dhe dizajni tërheqës, por dhe për nga integrimi i elementeve të përparuara të zhvillimit të qëndrueshëm.





Stacioni Multimodal i Tiranës - Një promovim publik i ideve që u zhvilluan dhe u shfaqën me synimin për të identifikuar idetë më krijuese, si pjesë e konkursit për Stacionin Multimodal të Tiranës. Dy aktivitete të zhvilluara njëkohësisht me konkursin u krijuan mundësinë qytetarëve të marrin pjesë dhe të rikthejnë hapësirën publike. Në ditën e hapjes, u organizua një koncert jazz-i i një grupi muzikor bashkëkohor, dhe në ditët pasuese u organizua shfaqja e një filmi shqipëtar, Binarët – nga Fejzo Muharremi, 1987) që prekte rëndësinë e hekurudhës në jetën e përditëshme të qytetarëve.

Stacioni me Shishe Plastike - U përrua gjatë Javëve të Arkitekturës në Tiranë, më 8 tetor 2012 struktura e parë me shishe plastike të ricikluara në Shqipëri, e cila do të shërbejë si një stacion autobuzi në Komunën e Kasharit. Stacioni i autobuzit me shishe, i cili është i vendosur në afërsi të Universitetit Polis, është i përbërë nga 12.000 shishe plastike (0.5l), të cilat u mbledhën nga konsumi i brendshëm në mjediset e U_POLIS si dhe vullnetarë të jashtëm. Ky projekt, origjinal në mënyrën e tij, për të ricikluar shishe plastike uji, synon të promovojë një ide unike dhe efikase në hartimin dhe riciklimin midis komunave dhe bashkive të Shqipërisë.

Historia e një apartamenti

Historia e një apartamenti - Katër tregime për katër apartamente në Tiranë, dy nga periudha komuniste, 1950 - 1990 dhe dy të ndërtuar pas viteve 1990. Këto apartamente ishin në qendër të një ekspozite të organizuar në ambientet e U_POLIS, duke shfaqur dhe analizuar ndryshimet funksionale, si kanë ndikuar në cilësinë e jetës së përdoruesve dhe si ata janë të lidhur me kushtet e përgjithshme në shoqëri në atë periudhë. Kjo ekspozitë është pjesë e një hulumtimi më të gjerë: "Cilësia e jetës ndryshon cilësinë e hapësirës", kryer në bashkëpunim me Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, përmes projektit të studimeve kërkimore me temë "Tipologjia e strehimit shqiptar në kontekstin e tij ballkanik".



Aktivitete Art & Dizajn

Sheshe me jetë - Gjatë Javëve të Arkitekturës në Tiranë, u zhvillua një konferencë katërditore mbi “Ripërvetësimin e Qytetit”, e organizuar nga Co-PLAN në bashkëpunim me Universitetin POLIS, EXPEDITIO dhe Kor-CSD. Konferenca u përqendrua në transformimin e shesheve të qytetit në vende të reja për komunitetin si një nga ngjarjet kryesore të Javës së Arkitektures në Tiranë.

The Pythagoras’ (un)constant (Ekspozitë) lindi si një inspirim nga projekti “Rijetëzimi i Shesheve në Qytetet Ballkanike”, qëllimi i të cilit është të reflektojë në ide të reja dhe krijuese në lidhje me sheshet dhe mënyrën se si njërëzitet i përdorin këto sheshe.

Dinamike Spirale dhe Qyteti

Dinamikat Spirale dhe Qyteti: Si vlerat i japin formë mjedisit urban” pregatitur nga Peter Nientied dhe Rudina Toto.

Në kuadrin e Javës së Arkitekturës në Tiranë (TAW: Tirana Architecture Week), 8-12 Tetor 2012, u prezantua studimi “Dinamikat Spirale dhe Qyteti: Si vlerat i japin formë mjedisit urban” pregatitur nga Peter Nientied dhe Rudina Toto. Studimi u mor me dilemën aktuale të arkitekturës bashkëkohore dhe shkollave të mendimit të planifikimit: si ti bëjmë qytetet të jetueshme. Duke bërë këtë, studimi hedh dritë edhe mbi shumë sfida si: nevoja për përcaktim më të mirë të problemeve që lidhen me mjedisin urban, nevoja për metoda që mund të diagnostikojnë problemet kryesore në qytet, identifikimi i veprimeve të ndryshme që mund të ndërmerren në një qytet gjithmonë në ndryshim, si dhe nevoja për qasje të reja që sjellin ndryshime efikase. Për tu përballur me këto sfida duhet, pikësisht, një model që do të ndihmonte në kuptimin dhe adresimin e tyre.





Studimi në fjalë ofron modelin e dinamikave spirale si instrument për diagnostikimin e evolucionit të qytetit dhe disekcionin e marrdhënieve komplekse ndërmjet qytetit dhe banorëve të tij. Ky model ndjek ndryshimet në sistemet e vlerave për të kuptuar tendencat dominuese në çdo shoqëri dhe për të zhvilluar një kuptim më thelbësor të qytetit në drejtimin fizik dhe socio-kulturor. Ilustrime të shprehjeve fizike të dinamikave spirale janë marrë nga dy shembuj konkretë në qytetin e Roterdamit në Hollandë si dhe një rast studimor i thelluar mbi Tiranën. Modeli i dinamikave spirale është përdorur për të shpjeguar dhe për t'i dhënë drejtim lëvizjeve dhe veprimtarive efektive që synojnë ta kthejnë qytetin në një mjedis të jetueshëm. Në kuadrin e temës së TAV – [Ri]Përvetësimi i qytetit – studimi ka për qëllim të zbulojë se çfarë duhet bërë për ta ripërvetësuar hapsirën publike në Tiranë dhe ofron kthimin e vlerave kolektive qytetit si një zgjidhje e mundshme.

Bed & Bunker

Një projekt bashkëpunimi ndërkombëtar mes studentëve të FH Mainz, nga Universiteti i Shkencave të Aplikuara (Gjermani), dhe Universitetit POLIS, Shkolla Ndërkombëtare e Arkitekturës dhe Politikave të Zhvillimit, (Tiranë, Shqipëri).

Ky projekt u frymëzua nga teza e diplomës së një studenteje shqiptare në FH Mainz – Arkitekturë Interiori, e cila ka lindur dhe është rritur në Tiranë. Nisur nga pamjet e shpeshta të bunkerizimit të hapësirave urbane dhe rurale, studentja pati idenë për t'i përshtatur këto struktura për përdorim turizmi individual. Projekti synoi që të rindëronte struktura strehimi rezistente ndaj ujit, për turistë, pa ndryshime radikale mbi bunkerin, si një alternativë e mirë e tendave të kampingut. Në vitet '70-'80, qindra-mijëra



bunkerë të llojeve të ndryshme u ndërtuan në Shqipëri për qëllime mbrojtjeje të vendit nga agresione të huaja. Por këto të fundit, pavarësisht frikës së madhe, nuk ndodhën asnjëherë, ndaj dhe bunkerët nuk u përdorën për qëllimin e tyre fillestar. Sot, bunkerët, kryesisht të rrumbullakët, gdhendin relievin nga malet deri në vijën bregdetare, në pozicione kyçe dhe fushëpamje të lartë. Projekti u fokusua në një bunker përgjatë vijës bregdetare (Tale, Lezhë), i cili është lehtësisht i aksesueshëm me makinë, në këmbë ose me biçikletë. Aktualisht, numërohen rreth 400, 000 bunkerë, duke përfshirë të gjitha llojet e bunkerëve, mbi tokë, nën tokë, të vegjël e të mëdhenj.

Fashion nuk është neutral: Tema e këtij *fashion show* ishte *Fashion Surrealist* duke përdorur materiale të riciklueshme, por jo vetëm. Studentët, të cilët kanë një njohje të mirë të elementeve surrealistike, e përqafuan lehtësisht konceptin e shfaqjes, dhe krijuan 15 veshje të asistuar gjatë procesit dhe nga një rrobaqepës profesionist.

Aktivitete Publike

Trans[a]cting the city, një numër turesh të improvizuara në qytet, synoi të promovonte eksperiencat sociale dhe profesionale, me qëllim zbulimin e itinerareve alternative dhe jotradicionale të qytetit. I hapur për të gjithë, shumëngjyrësh dhe i pasur në ndërveprim social për nga qasja, ky aktivitet shërbeu si një injeksion vitaliteti në qytet me anë të performancave të ndryshme me qëllim ri-aktivizimin e hapësirave publike në Tiranë.

Tirana Urban Bundles (TUB), një hapësirë e përbashkët, e cila u ofron njerëzve mundësinë e pjesëmarrjes dhe përfshirjes së tyre në procesin e krijimit dhe manaxhimit të mjedisit të tyre urban. TUB është gjithashtu një instrument politik i njerëzve të cilët përpiqen të ndikojnë zhvillimin e marrëdhënieve mes jetës publike e private në qytet. Në rastin e Tiranës, Urban Bundle ishte një instalacion i përkohshëm në një hapësirë publike për të lehtësuar takimet, mbledhjet e administratorëve, qytetarëve dhe ekspertëve me qëllim që të mbanin të hapur diskutimin për zhvillimin e kushteve urbane.

Ndër[veprimi] urban u përqendrua në ato hapësira të veçanta të cilat përbëjnë dhe imazhin urban, por, megjithatë i shpëtojnë shikimit. Ky aktivitet erdhi si një rikrijim ndërveprues i një mjedisi publik ekzistues, duke stimuluar shndërrimin e këtyre zonave urbane në fillesa të një vizioni të ri të qytetit. Në qendër të pritshmërive nga ky aktivitet, ishte vlerësimi i zonave ekzistuese të qytetit si sisteme të jetueshme urbane.

Loja e qytetit – një ndërtim strategjik dhe kufizuar në kohë, i cili filloi me ndarjen e roleve dhe prezantimin e problematikës imagjinare (ose të vërtetë) të qytetit. Loja u luajt në periudha të përcaktuara kohore, ku çdo orë që kalonte, përfaqësonte një periudhë më të gjatë kohore (p.sh. një vit). Në këtë mënyrë, për çdo orë që kalonte vëzhguesit



mund të ndiqnin zhvillimet në qytet. Njohuritë teknike në fusha të ndryshme përbënte një kusht paraprak për çdo lojtar të kësaj loje, ndonëse qytetarët vëzhgues ishin në gjendje të kuptonin rezultatet dhe t'i lidhnin ato me situata reale në qytet.

Workshop-e

Workshop Diagonal: U përqendrua në marrëdhëniet ndërlidhëse mes artit, dizajnit dhe arkitekturës. *Workshop*-et ofruan një mundësi për të punuar me fotografinë, dizajnin, dhe arkitekturën përmes një pikëpamjeje eksperimentale. Në mënyrë që të përfshihesh në një eksperiencë, krijimtaria është aftësia e vetme që duhet të synosh të zhvillosh.

Workshop Vertikal: “Qyteti si një fenomen përgjatë dimensionit vertikal” u fokusua në shtresat vertikale të qytetit të Tiranës si dhe rrethinat e tij. Përmes *workshop*-it, u prezantua shprehja “shtresë vertikale” për të theksuar konceptin e qytetit si një fenomen i mbledhjes dhe lulëzimit të materialeve fizike përgjatë dimensionit vertikal. Shpërhapja vertikale e funksioneve në Tiranë përbënte dhe temën kryesore të *workshop*-it, i cili i konsideroi hapësirat si katalizatorë për eksplorimin dhe rilindjen e kushteve specifike urbane dhe arkitektonike.

Workshop Horizontal: “Lumi i Tiranës si një shenjë e strukturimit horizontal të qytetit” u fokusua në lumin e Tiranës, si një përzierje komplekse dhe heterogjene e realiteteve, dhe një shenjë domethënëse e strukturimit horizontal të qytetit. *Workshop*i konsistoi në disa leksione, vëzhgime të drejtpërdrejta në terren, të pasuara nga disa mikrotransformime si veprime urbane frymëzuese. Ky *workshop* synoi të rriste ndërgjegjësimin në lidhje me lumin e Tiranës, si dhe të nxirte në pah potencialet e ardhshme të këtij elementi në kornizën më të madhe qytetare.





Projekte

Punë Kërkimore e Aplikuar për Politika Publike

Promovimi i Partneriteteve për Qytete të Mundësive të Përbashkëta

Projekti për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP)

Programi i Zhvillimit Rajonal në Shqipërinë Veriore

Rigjallërimi i Shesheve të Qyteteve Ballkanike

Planifikimi Strategjik, Buxhetimi, Manaxhimi Financiar dhe Performanca Fiskale

Huamarrja e Qeverisjes Vendore

Program Buxhetimi Afatmesëm Transparent dhe Profesional për Qeverisjen Vendore në Shqipëri – 2

Audit i Llogaridhënies Sociale

Zhvillimi i Platformës (ENV.net) në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi

Mbështetje Tematike për Manaxhimin e Mbetjeve

Zhvillimi dhe Zbatimi i Planit të Integruar Ndërvendor të Manaxhimit të Mbetjeve në Bashkitë Rrëshen dhe Rubik

Programi i Përkthimit të Librit

Gazetari më e Mirë për Edukim Qytetar mbi Hapësirat Urbane

Politika e Zhvillimit të Territorit të Komunës Bushat

Raste për Nominim të Vendeve të Dekadës Rome



Punë Kërkimore e Aplikuar për Politika Publike

Ndikimi i Politikëbërjes

Periodha e zbatimit: Dhjetor 2011 - 2012

Donatori: Instituti i Shoqërisë së Hapur, Budapest

Fondi: 71,851 \$

Zbatuar në: Shqipëri

Zbatuar nga: Co-PLAN


Viti 2012 shënoi vitin e dytë të zbatimit të programit “Ndikimi në Politikëbërje”, i cili është në fazën e dytë të zbatimit. Në thelb të qëllimit të programit është fuqizimi dhe konsolidimi i Co-PLAN si një “Institut Kërkimor Politikash” i suksesshëm dhe i respektuar në fushat e tij të ekspertizës, duke kontribuar në shoqërinë shqiptare nëpërmjet forcimit të politikëbërjes dhe të kontributit në arsimin e lartë në Shqipëri. Në këtë drejtim, objektivat e përgjithshëm të programit janë: **(1)**. hartimi dhe organizimi në koleksione i produkteve politike; **(2)**. hartimi dhe zbatimi i strategjive efikase të advokimit në lidhje me produktet e politikave; **(3)**. përmirësimi i kuadrit institucional dhe organizativ i Co-PLAN në përshtatje me qasjen dhe misionin e Co – PLAN (asistencë teknike, zgjerimi potencial rajonal, në bashkëpunim me Universitetin POLIS, ndikimi në politikëbërje).

Gjatë vitit 2012 u realizuan një numër aktivitete me rëndësi në ndikimin në politikëbërje, realizimin e produkteve politike dhe përmirësimin e kuadrit institucional dhe organizativ të Co-PLAN, ku spikatën publikimi i vëllimit të dytë të ‘Politikëndjekës apo Politikëbërës!’, organizimi dhe pjesëmarrja në Javët e Arkitekturës në Tiranë, dhe publikimi i një sërë manualesh në fushën e hapësirës publike, manaxhimit të mbetjeve urbane, dhe advokimit për fillestarë në Shqipëri. Në mënyrë të ngjashme me fazën I, faza e II-të e punës për Ndikimin në Politikëbërje mbështetet nga ‘Think Tank Fund’ i OSI, Budapest, për një periudhë 3-vjeçare (2011-2013).

Arritjet e vitit 2012, për secilin nga objektivat, janë të shprehura në formën e rezultateve në hartimin dhe organizimin e koleksioneve të produkteve politike, si dhe strategjive efikase të advokimit.

> U përfunduan: studimi mbi decentralizimin fiskal në Shqipëri, fokusuar në aspekte ligjore, territoriale, në transferta ndërqeveritare dhe huamarrjen vendore; 9 dokumente





politike, prej të cilëve 5 me mbështetjen e TTF; 2 studime në fushën e tipologjisë së banesave në Shqipëri; një studim mbi teorinë e 'Dinamikës spirale dhe qytetit', gjatë JAT 2012; Raport mbi gjendjen e planifikimit të territorit në Shqipëri.

> U përgatitën dhe publikuan: Manuali i Advokimit për Fillestarë në Shqipëri; Manuali "Rigjallërimi i Shesheve të Qyteteve në Qytetet Ballkanike"; Manuali "Planifikimi i Manaxhimit Lokal të Mbetjeve"; si dhe publikimi 'Praktika të reja për zhvillimin dhe manaxhimin e tokës në Shqipëri'

> U realizuan: 3 tryeza të rrumbullakëta në lidhje me decentralizimin fiskal gjatë muajit maj 2012; 3 tryeza të rrumbullakëta të PLGP-së në 15 bashki mbi gjendjen e planifikimit të territorit në Shqipëri.

> Co-PLAN dha kontribut në diskutimin e politikave të ngritur nga PLGP/USAID mbi decentralizimin fiskal.

> U hartua një kurrikul trajnimi mbi Programin e Buxhetimit afat-mesëm, dhe u zhvilluan trajnime trepjesëshe të 15 bashkive (30 pjesëmarrës).

> Co-PLAN mbështeti AKPT-në në shpërndarjen e 2 manualeve mbi planifikimin e territorit dhe zhvillimin e tokës, të përgatitura në fillim të vitit 2012.

> Co-PLAN organizoi: Trajnim 5-mujor për rishikimin e planeve territoriale të 10 bashkive; 3 Trajnime mbi huamarrjen vendore për 11 bashki, me një pjesëmarrje prej 12-20 përfaqësuesish.



Promovimi i partneriteteve për qytete të mundësive të përbashkëta

Periudha e zbatimit: 2010 - 2013

Donatori: Qeveria Hollandeze nëpërmjet programit MATRA

Fondi: 174,652 EUR

Zbatuar në: Fier, Durrës, Shkodër, Tiranë

Zbatuar nga: Co-PLAN dhe IHS, Holandë

Viti 2012 shënoi dhe vitin e tretë të zbatimit për projektin “Promovimi i Partneriteteve për Qytete të Mundësive të Përbashkëta – Ngritja e Kapaciteteve për Planifikimin Territorial Gjithpërfshirës”. Ky projekt mbështetet nga qeveria holandeze nëpërmjet programit MATRA në Shqipëri. Projekti zbatohet në bashkëpunim me IHS - Instituti për Strehimin dhe Zhvillimin Urban të Roterdamit (Holandë), Universitetin Polis, Ministrinë e Transportit dhe Punëve Publike (në bashkëpunim me Agjensinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit), shoqatat e njësive vendore, dhe bashkitë e Shkodrës, Durrësit dhe Fierit. Qëllimi i projektit është: **(1)**. Të promovojë planifikimin me pjesëmarrje në nivel lagjeje në bashkitë e Fierit, Durrësit dhe Shkodrës, duke harmonizuar interesat publike dhe private për zhvillimin hapësinor; **(2)**. Të zhvillojë një platformë për ngritjen e kapaciteteve dhe të sigurojë shpërndarjen e njohurive në zhvillimin e qëndrueshëm dhe të barabartë hapësinor që synojnë zyrtarët e qeverisë dhe profesionistëve; **(3)**. Të ngrejë koalicione të sektorit publik dhe shoqërisë civile për të formuluar rekomandime të politikës dhe për të zhvilluar instrumentet e implementimit për zhvillim të barabartë dhe të qëndrueshëm hapësinor.

Gjatë vitit 2012, projekti është fokusuar në prodhimin dhe shpërndarjen e njohurive në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm e të barabartë hapësinor. Nga rezultatet e arritura mund të veçojmë:

- > Hulumtimin dhe publikimin e disa dokumenteve politike në fushën e planifikimit të territorit.
- > Dokumentimi i një numri rastesh studimore në një publikim të titulluar “Praktikat e reja të zhvillimit dhe manaxhimit të tokës në Shqipëri”.
- > Vijëmesia me kurset pasuniversitare në planifikimin hapësinor, ku studentët u pajisën me njohuri nga teoria e zhvillimit urban për qytete gjithëpërfshirëse, si dhe njohuri të tjera, të gjitha në përputhje me politikën e udhëzimet e BE-së.





Projekti për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP)

Asistencë për qeverinë shqiptare dhe pushtetin vendor për planifikimin dhe administrimin e rritjes urbane dhe rajonale

Periodha e zbatimit: 2012 - 2016

Donatori: USAID

Fondi: 841,086 \$

Zbatuar në: Shqipëri

Zbatuar nga: Tetrattech ARD dhe Co-PLAN

Gjatë vitit 2012, Co-PLAN në bashkëpunim me TetraTech ARD ka punuar për zbatimin e Projektit të USAID-it për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP), i cili ka në fokus punën në nivel qendror dhe vendor për të mundësuar pranimin e parimeve të qeverisjes së decentralizuar, si dhe për të institucionalizuar metodat dhe teknikat praktike dhe efektive për drejtimin e bashkive. Projekti shtrihet në katër fusha: **(1)**. Mbështetje për qeverinë shqiptare për të zbatuar politika efektive dhe legjislacionin e decentralizimit; **(2)**. Përmirësimi i qeverisjes vendore; **(3)**. Përmirësimi i menaxhimit të shërbimeve vendore; **(4)**. Asistencë për qeverinë shqiptare dhe pushtetin vendor për planifikimin dhe administrimin e rritjes urbane dhe rajonale. Kontributi i Co-PLAN në zbatim të projektit fokusohet në komponentët 1 dhe 4.

Gjatë vitit 2012, në linjë me këto fusha, janë organizuar aktivitetet si më poshtë.

> U organizuan 6 takime me bashkitë e Shkodrës, Beratit, Korçës, Fushë - Krujës, Kamzës, Fierit, Gjirokastrës dhe Pogradecit për të kuptuar ndryshimet që Planet përkatëse, përfshirë politikat, rregulloret dhe dokumente të tjera të kërkuara me ligj, duhet të pësojnë për t'u përputhur me kuadrin e ri ligjor.

> U rishikuan dhe u miratuan në këshillat vendor Planet e Përgjithshme Vendore të Bashkive të Shkodrës, Beratit, Korçës, Fushë-Krujës, Kamzës, Fierit, Gjirokastrës dhe Pogradecit. U miratuan në Këshillin Kombëtar të Territorit (KKT) Planet e Përgjithshme Vendore të Bashkive të Beratit dhe Kamzës.

> U mbështet AKPT për të përgatitur një sërë aktesh nënligjore, si struktura e unifikuar e raportit të territorit, etj.

Programi i Zhvillimit Rajonal në Shqipërinë Veriore

Periudha e zbatimit: Janar 2011 - Janar 2014

Donatori: Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)

Fondi: 224,800 Euro

Zbatuar në: Rajoni Shkodër, Lezhë

Zbatuar nga: ÖAR, Intercooperation dhe Co-PLAN

“Programi për Zhvillimin Rajonal në Shqipërinë Veriore” vjen si një përpjekje për të mbështetur në mënyrë aktive zhvillimin rajonal në rajonet Shkodër- Lezhë, ku pabarazitë mes popullsisë urbane-rurale janë dhe më të mëdha. Ky program mbështetet nga agjencitë donatore të Austrisë e Zvicrës dhe ka një vlerë mbi 4 milion euro, për t’u zbatuar në një periudhë 4-vjeçare. Objektivi i përgjithshëm i programit është që të kontribuojë qartazi për një zhvillim të drejtë social dhe ekonomik të të dy rajoneve dhe, përveç kësaj, të mbështesë përpjekjet e qeverisë shqiptare në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.

Duke njohur dëshirën e Shqipërisë për t’u bërë anëtare e ardhshme e Bashkimit Evropian, programi do të synojë të puqë praktikrat dhe rregulloret zhvillimore kombëtare me ato të Bashkimit Evropian. Programi ka katër rezultate të pritshme (RP): **(1).** Një kuadër institucional efektiv për decentralizimin, i cili synon rezultate të drejta zhvillimore, është mbështetur; **(2).** Kapacitetet e këshillave të qarqeve për planifikimin e zhvillimit rajonal dhe funksionet e deleguara janë përforcuar; **(3).** Procesi i planifikimit gjithëpërfshirës dhe i buxhetimit të zhvillimit rajonal në rajonet e Shkodrës dhe Lezhë është zhvilluar dhe institucionalizuar; **(4).** Zhvillimi rajonal është përshpejtuar nëpërmjet nismave për projekte dhe zbatimit efektiv.

Katër rezultatet e pritshme janë të ndërlidhura, duke siguruar një qasje gjithëpërfshirëse, sistematike e shumëpalëshe në mbështetjen e zhvillimit rajonal në Shqipërinë Veriore, në një linjë me agjendën integruese për në BE. Megjithëse partnerët kryesorë janë dy këshillat e qarqeve, PZHR do të mbështesë nivelin kombëtar (kryesisht RP 1), qeveritë lokale (kryesisht RP 4) dhe aktorë të tjerë lokalë e rajonalë. PZHR do të mbështesë kuadrin ligjor dhe institucional (RP 1 dhe RP 2), planifikimin rajonal me pjesëmarrje, buxhetimin afatmesëm (RP 3) dhe zbatimin e projekteve dhe nismave (RP 4) me një





fokus të qartë në zhvillimin e kapaciteteve të partnerëve. Manaxhimi dhe aftësia për të thithur fonde të ardhshme nga BE në fund do të varen nga kapacitetet e këshillave të qarqeve dhe njësive të qeverisjes lokale për të hartuar dhe menaxhuar projekte, gjë që është thelbi i PZHR-së. Këshilli i qarkut të Shkodrës dhe ai i Lezhës janë përfituesit direkt të projektit.

Aktivitetet e kryera gjatë vitit 2012, në një pjesë të të cilave Co-PLAN ka dhënë kontribut:

- > U organizua një trajnim mbi politikat e BE, programet dhe fondet, në qarkun e Shkodrës dhe të Lezhës.
- > U përgatitën projekte mbi zhvillimin rajonal në qarkun e Shkodrës dhe të Lezhës.
- > U mbajt një workshop për fillimin e procesit të riorganizimit të strukturave të qarkut në qarkun e Shkodrës dhe të Lezhës .
- > U organizua një seminar ndërkombëtar mbi “Gjendjen e Rajonalizimit në Shqipëri: Progresi dhe Sfidat”.
- > U zhvillua një trajnim mbi profilizimin socioekonomik dhe analizën e nevojave.
- > U kryen dy vizita studimore në Kroaci, Austri e Gjermani.
- > U lançua Fondi për Zhvillimin Rajonal.
- > U krye një trajnim mbi “Monitorimin dhe Vlerësimin e Strategjive dhe Planeve të Zhvillimit Rajonal”.

Rigjallërimi i Shesheve të Qyteteve Ballkanike

Periodha e zbatimit: 2011 - 2012

Donatori: Swiss Cultural Program

Fondi: 115,303 CHF

Zbatuar në: Shqipëri, Mali i Zi, Maqedoni

Zbatuar nga: Co-PLAN, EXPEDITIO dhe Coalition for Sustainable Development (CSD)



Projekti, i financuar nga Swiss Cultural Program, u zbatua në bashkëpunim nga 4 organizata në 3 shtete: Co-PLAN, Universitetit Polis në Tiranë, Shqipëri - Koalicioni për Zhvillim të Qëndrueshëm - CSD, nga Shkupi, Maqedonia dhe EXPEDITIO - Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm Hapsinor nga Kotorri, Mali i Zi.

Rigjallërimi i Shesheve të Qyteteve Ballkanike reflekton mbi ide të reja krijuese të përdorimit të hapësirave publike, pas konsultimit me njerëzit që jetojnë dhe i përdorin ato mbi problematikën dhe vlerat e këtyre hapësirave. Sheshet e qytetit mishërojnë energjitë e njerëzve dhe për këtë arsye ne duhet të kuptojmë se çfarë do të thotë për sheshet e qytetit sociale dhe shprehjes kulturore të qytetarëve dhe çfarë është e nevojshme për të sjellë në jetë përsëri sheshet. Në këtë linjë, projekti synon të kontribuojë në shtimin e urave të lidhëse mes aktorëve të ndryshëm dhe për të lehtësuar një proces të bazuar në komunitet që angazhohet një gamë të plotë të palëve të interesuara (qytetarët, profesionistë, hartuesit e politikave), dhe i sjell njerëzit me ide të ndryshme në një proces dialogu gjithëpërfshirës që prodhon rekomandime me ndikime të rëndësishme. Si objektivin e saj të përgjithshëm, ky projekt synon të kontribuojë në ringjalljen e shesheve të qytetit si vende publike të qëndrueshëm, që nxisin identitetin kulturor dhe promovojnë diversitetin nëpërmjet zbatimit të politikave publike dhe pjesëmarrjes aktive të komunitetit.

Për vitin 2012, projekti pati disa aktivitete kryesisht në formën e workshopeve, ekspozitave dhe konferencave, ku veçojmë:

> Dialogun me qytetarët “Diskuto hapsirën tënde” në qytetin e Tiranës.

> Never City – workshop i drejtuar nga artisti Armando Lulaj.

> Konferenca “Vibrant Square” dhe Pythagoras (Un)Constant të zhvilluara gjatë TAVV 2012.



Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp)

Planifikimi Strategjik, Buxhetimi, Manaxhimi Financiar dhe Performanca Fiskale

Periudha e zbatimit: 2012

Donatori: Agjensia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) nëpërmjet dldp

Fondi: 34,347.5 Euro

Zbatuar në: Qarku Shkodër, Lezhë

Zbatuar nga: Co-PLAN

Sikurse edhe në vitin 2011, Co-PLAN vazhdoi të punojë me programin dldp-II fokusuar në komponentin "Planifikimi Strategjik, Buxheti dhe Menaxhimi Financiar dhe Performanca Fiskale". Si viti i dytë i programit dldp-II CoPLAN punoi në realizimin e qëllimit kryesor të programit: "forcimi i kapaciteteve në rajonin Shkodër dhe Lezhë për të kontribuar në zhvillimin rajonal në veri të Shqipërisë dhe në reformën e decentralizimit në nivel kombëtar". Duke u fokusuar në qëllimin kryesor, Co-PLAN vazhdoi të punojë për të siguruar përmbushjen e dy outputeve kryesore të projektit: (1) Kapacitetet e NjQV-ve në Planifikimin Strategjik (PSZH) dhe menaxhimin financiar (përfshirë Programin Buxhetor Afatmesëm – PBA) janë përmirësuar dhe NjQV-të aplikojnë instrumente dhe metoda të planifikimit strategjik, të lidhura me buxhetin vjetor dhe Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA); (2) Kapacitetet e NjQV-ve në menaxhimin financiar dhe fiskal, përfshirë procesin e Programit Buxhetor Afatmesëm janë forcuar.

Për vitin 2012, janë asistuar përmes proceseve pjesëmarrëse në të dy komponentët 8 Njësi të Qeverisjes Vendore duke arritur rezultatet si më poshtë:

- > 5 PSZH të hartuara sipas kërkesave të PBA-së për Komunitet Shkrel, Gruemirë, Bushat, Balldren, dhe Bashkinë Fushë - Arrëz - e rishikuar.
- > 2 PBA të hartuara dhe të lidhura me PSZH-të respektive në Komunën Bushat dhe Bashkinë Pukë dhe 4 PBA të rishikuara dhe të lidhura me PSZH-të respektive në Bashkitë Fushë - Arrëz, Vau i Dejës dhe Komunitet Dajç Bregu i Bunës, Bushat dhe Balldren.
- > 6 Instrumente të Planifikimit Financiar të zhvilluara në bashkëpunim me stafet e NjQV-ve.





> Co-PLAN punoi në forcimin e Qendrës së Kompetencës me grupin e ekspertëve ndërvendorë duke asistuar 3 grupe të ekspertëve ndërvendorë në zhvillimin e tre Rasteve Studimore si:

> Zbatimi i PSZh/ePBA në Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe FPT-së - Bashkia Vau i Dejës dhe Komuna Bushat.

> Informimi Publikut në PBA/e PSZh - Rasti studimor Komuna Dajç Bregu Bunës dhe Kallmet.

> Përfshirja sociale në PSZh/e PBA në një NJQV (Rasti studimor Komuna Dajç/ePBA në një NJQV (Rasti studimor Komuna Dajç, Bregu Bunës).

> Në lidhje me modulet e trajnimit, Co-PLAN punoi në rishikimin dhe përmirësimin e 5 moduleve të trajnimit të zhvilluara në vitin 2011.



Huamarrja e Qeverisjes Vendore

Sfida e NJQV-ve dhe Zhvillimi Ekonomik Lokal

Periudha e zbatimit: Prill 2011 – Nëntor 2012

Donatori: Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë

Fondi: 26,935 \$

Zbatuar në: Shqipëri

Zbatuar nga: Co-PLAN



Gjatë vitit 2012, Co-PLAN ndër morri një projekt për të vlerësuar situatën në lidhje me huamarrjen vendore në Shqipëri. Me mbështetjen e Fondacionit për Shoqërinë e Hapur në Shqipëri, dhe në partneritet me Ministrinë e Financave, Co-PLAN punoi në analizimin e situatës në aspekte si: qëllimi i investimit, vlerësimi i ndikimit të tij në zhvillimin ekonomik vendor dhe asistimi i njërive të qeverisjes vendore (nëpërmjet trajnimeve të stafit përgjegjës) për hartimin dhe përzgjedhjen në mënyrë eficiente të projekteve të financuara nëpërmjet huasë/borxhit. Objektivat e këtij projekti janë: **(1).** Të ofrojë një vlerësim të përgjithshëm të situatës në lidhje me qëllimin e përdorimit të huave të marra/kërkuara prej NJQV-ve dhe ndikimin e pritshëm të tyre në zhvillimin ekonomik vendor; **(2).** Të kontribuojë (së bashku me aktorë të tjerë) në ngritjen e kapaciteteve të stafit të NJQV-ve në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me hartimin e studimeve të mundshmërisë dhe përgatitjen e projekteve për të aplikuar për kredi; **(3).** Të asistojë NJQV-të, në procesin e përgatitjes së projekteve të mundshme për t'u financuar nëpërmjet huasë, duke u fokusuar në studimin e mundshmërisë së investimit dhe forma të tjera të vlerësimit të ndikimit të projektit në zhvillimin ekonomik lokal.

Për vitin 2012, projekti pati disa aktivitete kryesisht në formën e vlerësimeve, e trajnimeve, ku veçojmë:

> U identifikuan nevojat dhe qëllimet e përdorimit të huave të marra/kërkuara përmes 28 intervistave të realizuara me NJQVtë; si dhe u vlerësuan mundësitë për të kredituar NJQV-në nga bankat dhe Ministrisa e Financave. Gjetjet e raportit të vlerësimit u ndanë në një tryezë diskutimi me NJQV-të, OSFA, bankat dhe donatorë të fushës.

> U hartua dhe u konsultua kurrikula e trajnimit për 3 modulet, si dhe u organizuan trajnimet me NJQVtë.

> U asistuan 3 Njv në vlerësimin e potencialit të tyre financiar.

Program Buxhetimi Afatmesëm Transparent dhe Profesional për Qeverisjen Vendore në Shqipëri – 2

Periudha e zbatimit: 2011 - 2012

Donatori: Instituti i Shoqërisë së Hapur, Budapest

Fondi: 122,710 \$

Zbatuar në: Bashkitë Berat, Fier, Lezhë dhe Korçë

Zbatuar nga: Co-PLAN



Projekti “Program buxhetimi afatmesëm transparent dhe profesional për qeverisjen vendore në Shqipëri - faza II” vijoi zbatimin përgjatë vitit 2012. Projekti ndihmon NJQV-të për të përgatitur programe buxhetimi afat-mesme të lidhura me dokumente zhvillimi strategjik. Kjo fazë e dytë fokusohet në tri çështje kryesore: **(1)**. përmirësimin e kapaciteteve të zyrtarëve qeveritarë lokale në lidhje me çështjet e manaxhimit financiar në përgjithësi dhe përgatitjen “Programit të Buxhetimit Afatmesëm” në veçanti; **(2)**. përmirësimin e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile për të monitoruar zbatimin e PBA-së, bazuar në tregues të qartë të performancës; dhe **(3)**. përmirësimin e mëtejshëm të legjislacionit dytësor për përgatitjen PBA-së në nivel vendor në Shqipëri.

Fokusi i aktiviteteve për vitin 2012 ishte në organizimin e trajnimit për zyrtarët e pushtetit vendor, OSHC, dhe anëtarë të këshillave vendorë në lidhje me çështje të financave bashkiake, si dhe përgatitjes së udhëzimeve për pushtetin vendor mbi përgatitjen e PBA-ve në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, si dhe:

- > Përmirësimi i kapaciteteve të zyrtarëve të qeverisjes lokale në lidhje me çështjet financiare të manaxhimit për përgatitjen e programit të përgjithshëm dhe PBA-së në veçanti, si dhe i OSHC-së për të monitoruar zbatimin e PBA-së bazuar në tregues të qartë të performancës.

- > Përmirësimin e mëtejshëm të legjislacionit dytësor për përgatitjen PBA-ve në nivel lokal në Shqipëri.



Audit i Llogaridhënies Sociale

Periodha e zbatimit: Gusht 2012 – Mars 2013

Donatori: Banka Botërore

Fondi: 109,890 \$

Zbatuar në: Durrës (AL), Shkup (MQ), Prishtinë (KS), Banja Luka e Sarajevë (BiH)

Zbatuar nga: I2UD dhe Co-PLAN

“Audit i Llogaridhënies Sociale”, financuar nga Banka Botërore dhe zbatuar në partneritet nga Co-PLAN dhe Instituti për Zhvillim Urban Ndërkombëtar kishte në fokus sfidën e zhvillimit të qendrueshëm urban, dhe përjashtimit social. Projekti, i cili u zbatua njëkohësisht në pesë qytete të rajonit, Durrës (Shqipëri), Prishtinë (Kosovë), Shkup (Maqedoni), Banja Luka e Sarajevo (Bosnje Herzegovinë), kishte për qëllim të rriste njohurinë dhe ndërgjegjësimin në çështje të llogaridhënies sociale mes grupeve të interesit, si dhe të fuqizojë integritetin e shërbimeve publike në pesë qytete pilot në Europën juglindore, përkatësisht në: Durrës, Prishtinë, Shkup, Banja Lukë, e Sarajevë. Co-PLAN dhe I2UD u asistuan nga organizata lokale në secilin prej qyteteve për realizimin e auditit në të tre fazat e tij: Archis Intervention Prishtina (Kosovë), Coalition for Sustainable Development (Maqedoni), dhe US Alumni Association (Bosnje Herzegovinë). Një aspekt i rëndësishëm i auditit ishte vlerësimi i mekanizmave aktualë të llogaridhënies sociale në bashkitë e përzgjedhura, dhe i kufizimeve të tyre, për të zhvilluar qasje të reja dhe instrumente të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, për të përmirësuar qeverisjen me pjesëmarrje në nivel qyteti. Për vitin 2012, projekti pati disa aktivitete kryesisht në formën e punës kërkimore, fokus grupeve dhe *workshopeve*:

- > U hartuan profile analitik të secilit qytet në lidhje me çështje të qeverisjes, llogaridhënies, ofrimit të shërbimeve publike dhe grupet e marxhinalizuara të qytetit.
- > U mbajtën mesatarisht 12 *focus grupe* në secilin qytet me përfaqësues të grupeve të marxhinalizuar dhe 31 intervista me grupe interesi, gjetjet e të cilave u sintetizuan në një raport të detajuar.
- > U organizuan 5 seminare me pjesëmarrje të gjerë qytetare e grupesh interesi, ku u zhvilluan një numër skenarësh për përmirësim të mekanizmave aktualë të llogaridhënies në secilin qytet.





Zhvillimi i Platformës (ENV.net) në Ballkanin Perëndimor dhe në Turqi

T'u japim zë qytetarëve për të ndikuar në procesin e reformave mjedisore për integrimin në BE.

Periudha e zbatimit: 2012 - 2014

Donatori: BE (bashkëfinancim i Co-PLAN)

Fondi: 79,614.42 Euro

Zbatuar në: Shqipëri

Zbatuar nga: Co-PLAN (në Shqipëri) dhe Punto Sud, Tema, ATRC, EEB, EASD në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi.

Projekti më i ri për Co-PLAN për vitin 2012, është "Zhvillimi i Platformës (ENV.net) në Ballkanin Perëndimor dhe në Turqi: t'u japim zë qytetarëve për të ndikuar në procesin e reformave mjedisore për integrimin në BE". Ky projekt vjen si një bashkëfinancim nga BE, dhe zbatohet në partneritet në katër vende të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë. Projekti ka si qëllim të nxisë integrimin e vendeve partnere në BE, duke ndikuar në procesin e përfarimit të legjislacionit mjedisor me *acquis* të BE, duke promovuar vlera dhe struktura demokratike, të drejtat e njeriut dhe përfshirjen sociale në një shoqëri civile sa më aktive dhe dinamike. Projekti ka si objektiv një angazhim dhe kapacitet më të madh të platformës ENV.net për t'u dhënë qytetarëve një zë për të indikuar në procesin e reformave publike në fushën e mjedisit me anë të analizave, monitorimit dhe advokimit. Përgjatë periudhës së zbatimit të projektit 2012-2014, planifikohet të zhvillohen aktivitete në tre linja kryesore:

> Aktivitete ndërgjegjësimi dhe informimi në lidhje me legjislacionin mjedisor të BE-së *acquis* dhe politikat mjedisore të BE-së.

> Organizimi i konsultimeve të rregullta me aktorët kryesorë në nivel kombëtar dhe rajonal; prodhimi dhe shpërndarja e materialeve informuese.

> Trajnime dhe ngritje kapacitetesh administrative për partnerët e ENV.net dhe për aktorët në nivel kombëtar; analiza për zhvillimin organizativ dhe qeverisjen nga Organizata të Shoqërisë Civile.

Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp)

Mbështetje Tematike për Manaxhimin e Mbetjeve

Periudha e zbatimit: 2012

Donatori: Agjensia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)
nëpërmjet dldp

Fondi: 29,850 Euro

Zbatuar në: Qarku Shkodër, Lezhë

Zbatuar nga: Co-PLAN



Projekti është zbatuar gjatë periudhës 10 prill 2012 deri në dhjetor 2012, në gjashtë njësi të qeverisjes vendore në qarkun e Shkodrës dhe të Lezhës. Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, është kontraktuar nga HELVETAS Swiss Intercooperation (HSI Albania), për të mbështetur njësitë vendore në qarkun Shkodër dhe të Lezhës në kuadër të fazës së dytë të programit të dldp.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të ofrojë asistencë teknike për njësitë e qeverisjes vendore që kanë zhvilluar më parë një plan lokal për manaxhimin e mbetjeve, duke i orientuar dhe ndihmuar ato të reduktojnë kostot e shërbimeve të mbetjeve, të rrisin të ardhurat dhe të optimizojnë shërbimet, si dhe të shpërndajë praktikat dhe modelet më të mira në nivel rajonal dhe kombëtar.

Asistenca teknike është organizuar sipas katër shtyllave tematike që mundësojnë zbatimin e sukseshëm të planeve lokale të manaxhimit të mbetjeve, nëpërmjet: **(1)**. Organizimit të shërbimeve efektive të grumbullimit të mbetjeve; **(2)**. Përmirësimit të praktikave dhe njohurive të monitorimit, kontrollit, informimit dhe komunikimit; **(3)**. Manaxhimit më të mirë financiar në drejtim të analizimit dhe kontrollit të kostove të shërbimeve, rritjes së të ardhurave dhe sigurimit të financimeve të nevojshme për praktikat e manaxhimit të mbetjeve; **(4)**. Zhvillimin dhe përmirësimin e kontratave, proceseve të kontraktimit dhe prokurimit, si dhe të krijimit apo përmirësimit të rregullave lokale të manaxhimit të mbetjeve, si dhe përgjegjësitë e detyrimet e qytetarëve dhe bizneseve, autoriteve dhe operatorit të shërbimit.

Bazuar në kontekstin vendor, njohuritë dhe në asistencën e ofruara gjatë aktiviteteve të trajnimit dhe konsultimeve, ekspertët lokalë zhvilluan modelet e tyre të aplikueshme të cilat lidhen drejtpërdrejt me procesin e zbatimit të planeve dhe kanë potencial të madh për t'u zbatuar në njësitë respektive vendore.





Përgjatë vitit 2012, janë arritur rezultatet e mëposhtme:

- > U trajnuan 99 ekspertë lokalë dhe rajonalë në aspektet të manaxhimit të mbetjeve sipas tematikeve të zbatimit të planeve, me kurrikula të hartuara nga ekspertët.
- > U mbajtën rreth 40 konsulta me 25 ekspertë lokalë nga 6 njësi vendore (12% ishin femra), minimalisht për njërën nga 4 tematikat e programit.
- > U zhvilluan materiale praktike si dhe 6-8 raste të mira studimore nga ekspertët lokalë.
- > 4 prej 6 njësive të qeverisjes vendore përfunduan procedurat e testimit dhe identifikuan potencialet dhe mundësitë për përmirësimin e kostos së shërbimeve të grumbullimit të mbetjeve;
- > 4 raporte tematike përfundimtare u zhvilluan (një për secilin modul), që japin konkluzionet dhe rekomandimet e duhura për mënyrat dhe masat për reduktimin e kostove të shërbimeve të grumbullimit të mbetjeve dhe rritjes së të ardhurave, rreth sfidave dhe pengesave që hasin zakonisht njësitë vendore për zbatimin e planeve vendore të manaxhimit të mbetjeve.

Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp)

Zhvillimi dhe zbatimi i planit të integruar ndërvendor të manaxhimit të mbetjeve në bashkitë Rrëshen dhe Rubik

Periudha e zbatimit: Prill 2011 – Nëntor 2012

Donatori: dldp

Fondi: 26,500 Euro

Zbatuar në: Bashkia Rrëshen, Rubik

Zbatuar nga: Co-PLAN



Projekti u zbatua gjatë periudhës prill 2011 - nëntor 2012, në bashkitë Rrëshen dhe Rubik, si pjesë e programit për decentralizim dhe zhvillim lokal (dldp-2). Gjatë vitit 2012, u vijua puna me grupin e punës dhe bashkëpunëtorët lokalë për zhvillimin, konsultimin dhe finalizimin e planit ndërvendor të manaxhimit të mbetjeve, si dhe kryerjen e investimeve e seancave të trajnimeve e konsultimeve. Projekti kontribuoi drejtpërdrejt që: shërbimet publike në njësitë vendore të zgjedhura janë përmirësuar, duke siguruar aksesin e barabartë për të gjithë banorët, si dhe gratë, shtresat në nevojë dhe grupet e tjera të marginalizuara.

Në mënyrë të përmbledhur, rezultatet e projektit për vitin 2012 janë:

- > Zhvillimi i planit ndërvendor për manaxhimin e integruar të mbetjeve, i matricës së vlerësimit të objektivave, dhe investimet në infrastrukturën e manaxhimit të mbetjeve, duke përmirësuar shërbimin e pastrimit dhe organizimin e shërbimeve më efikente.
- > Zhvillimi i një skeme të përbashkët institucionale, i një rregulloreje operative dhe të sigurisë për landfillin, si dhe rritja e kapaciteteve vendore, duke përmirësuar praktikave të manaxhimit dhe trajtimit të mbetjeve në landfillin e Rrëshenit.
- > Rritja e njohurive dhe kapaciteteve të stafit lokal të bashkive Rrëshen dhe Rubik.
- > Bashkëpunëtorët lokalë, si përfaqësues të OJQ-ve, sektorit privat, këshilltarë bashkiakë dhe grupet e grave dhe institucioneve arsimore u përfshinë në mënyrë sistematike gjatë seancave të konsultimit për diskutimin e aspekteve kyç të zhvillimit të planit.

Programi i Përkthimit të Librit




Periudha e zbatimit: Shtator 2012 - Gusht 2013

Donatori: Ambasada Amerikane

Fondi: 25,000 \$

Zbatuar në: Shqipëri

Zbatuar nga: Co-PLAN



Angazhimi i Co-PLAN në fushën kërkimore dhe të njohuribërjes ka qenë pjesë e pandashme e aktiviteteve në nivel projekti apo dhe në nivel organizativ. Ky angazhim fitoi një dimension të ri me krijimin e një sinergjie me Universitetin POLIS, Shkolla Ndërkombëtare e Arkitekturës dhe Politikave të Zhvillimit Urban në vitin 2006, duke kontribuar së bashku në krijimin e një mase kritike në fushën e zhvillimit urban dhe manaxhimit mjedisor, nëpërmjet edukimit dhe aktiviteteve ndërgjegjësuese. Krahas kësaj qasje, Co-PLAN sigurohet që eksperiencia, njohuria dhe praktikat e përfthuara nga projekte të ndryshme të dokumentohet në formën e manualeve apo udhëzuesve për t'u ndarë me grupet e interesit për rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e praktikave të punës në fusha të ndryshme. Në këtë linjë, Co-PLAN në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane në Tiranë, u angazhua në zbatimin e projektit "Programi për Përkthimin e Librave", duke mundësuar kështu përkthimin në gjuhën shqipe të tri publikimeve shumë të rëndësishme tematike, përkatësisht të fushës së mjedisit, financave publike, dhe arkitekturës/planifikimit. Tri publikimet, të cilat priten të publikohen gjatë vitit 2013, janë: **(1)**. "Design with Nature" nga Ian L. McHarg; **(2)**. "Strategic Environmental Assessment in Transport and Land Use" nga Thomas B. Fischer; dhe **(3)**. "Public Finance in Developing and Transitional Countries - Essays in Honor of Richard Bird" nga Wallace E. Oates.

Përgjatë vitit 2012 disa nga rezultatet kryesore të arritura janë

> U konsultan ekspertë të fushës së mjedisit, financave publike dhe planifikimit urban për identifikimin e 3 publikimeve më të rëndësishme në secilën fushë.

> Pas marjes së drejtave të përkthimit nga shtëpitë botuese përkatëse, u testuan, intervistuan dhe u përzgjedhën 3 përkthyes tematikë, të cilët filluan përkthimin, të asistuar paralelisht nga ekspertë të fushës për konsulta të natyrës teknike.

Gazetari më e mirë për Edukim Qytetar mbi Hapësirat Urbane

Nga një qytet nevojash në një qytet mundësish

Periodha e zbatimit: Prill 2012- Maj 2013

Donatori: Ambasada Amerikane në Tiranë, përmes Komisionit të Granteve për Demokracinë

Fondi: 54,970 \$ (Bashkëfinancim i Co-PLAN)

Zbatuar në: Shqipëri

Zbatuar nga: Co-PLAN, Universiteti POLIS, Televizioni Albanian Screen

Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit gjatë viteve, sidomos duke filluar nga viti 2011, është fokusuar në zgjerimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të qasjes së komunikimit dhe vizibilitetit me grupe të ndryshme interesi.

Bashkë me angazhimin për të nxitur një transformim të prekshëm social dhe ndryshime pozitive në terren për një qeverisje më të mirë urbane, Co-PLAN dhe Ambasada Amerikane në Tiranë investuan në edukimin e medias shqiptare, si dhe publikut më të gjerë në lidhje me çështje urbane për të kaluar nga një qytet nevojash në një qytet mundësish. Projekti konsistoi në organizimin e një serie debatesh publike mbi çështje të hapësirave publike, si: prona private dhe e drejta për të zhvilluar skema të zhvillimit të lagjeve, trysnia e zhvillimit urban dhe zonat e mbrojtura urbane etj. Diskutimet publike u përgatitën në bashkëpunim me Universitetin POLIS dhe televizionin Albanian Screen dhe u transmetuan për një periudhë pesëjavore në orare me shikueshmëri të lartë, nën titullin "Dilema Urbane", të moderuar nga gazetari i mirënjohur z. Aleksandër Furxhi. Objektivat e projektit janë: (1) Programet u Përmirësimi i edukimit qytetar mbi rolin dhe përgjegjësitë e secilit aktor në procesin e transformimit të qytetit; (2) Dhënie kontribut në përmirësimin e gazetarisë, duke ofruar modele të reja të 'gazetarisë urbane' të cilat shkojnë përtej aspektit politik dhe argëtues; (3) Promovim i ndërgjegjësimit publik dhe vlerave të komunitetit në lidhje me qytet-bërjen dhe transformimin e hapësirave publike. Përgjatë vitit 2012 disa nga rezultatet kryesore të arritura janë:

> U ngritën grupe pune dhe u identifikuan 5 raste studimore nga qytete të ndryshme shqiptare, përkatësisht: Durrësi, Tirana, Lushnja, Shkodra dhe Vlora.



- > U identifikuan dhe u përzgjedhën pjesëmarrës në secilin program, me të cilët u diskutua koncepti i programit dhe problematikave të trajtuara paraprakisht, dhe u seleksionua media më e përshtatshme.
- > U përgatitën konsulta me moderatorin e programit për përvetësim sa më të mirë të aspekteve teknike të çështjeve në trajtim.
- > Në bashkëpunim me një ekspert multimediash, u ideuan dhe u realizuan 9 filma me minutazh të shkurtër për transmetim në secilin program (2 filma për secilin program).
- > U regjistruan dhe u transmetuan pesë programe 'Dilema Urbane', me një kohëzgjatje prej 90 min secili.



Politika e Zhvillimit të Territorit të Komunës Bushat

Periudha e zbatimit: Prill 2012 - Tetor 2012

Donatori: SKL International

Fondi: 19,500 Euro


Zbatuar në: Komuna Bushat

Zbatuar nga: Co-PLAN

Në kuadër të ligjit nr. 10119 dhe me ndihmën e Shoqatës së Komunave të Shqipërisë, Komuna e Bushatit ndërmori, në prill 2012, nismën e hartimit të dokumentit të Politikës së Zhvillimit të Territorit. Hartimi i këtij dokumenti u mbështetet nga projekti DAAC Phase – Out i financuar nga SIDA, Agjencia Suedeze për Zhvillimin në Tiranë dhe u realizua nga një grup i përbashkët pune i përbërë nga përfaqësues të Komunës Bushat dhe Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit.

Qëllimi i dokumentit ishte: **(1).** të përmbushte detyrimet ligjore sipas përcaktimeve të ligjit 10119, duke i hapur rrugën hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) dhe rregulloreve përkatëse të planifikimit të territorit; dhe **(2).** të orientonte zhvillimin e ardhshëm territorial, ekonomik, social dhe mjedisor të Komunës. Përmbushja e qëllimit nr.1 u realizuar nëpërmjet njohjes së bazës ligjore, duke respektuar formën dhe strukturën e propozuar prej tij. Ndërsa qëllimi nr. 2 u realizuar nëpërmjet njohjes dhe analizës së territorit të Komunës, studimit të hartave ekzistuese, njohjes së drejtpërdrejtë të territorit, literaturës etj. Kjo fazë u pasua nga hartimi i vizionit të territorit të Komunës.

Hartimi i dokumentit të Politikës së Zhvillimit të Territorit është realizuar përmes një procesi i cili ka përfshirë në çdo hap të tij komunitetin qoftë nëpërmjet takimeve konsultative të realizuara në mjediset e Komunës me përfaqësues të grupeve të interesit, qoftë nëpërmjet pyetësorëve të realizuar në terren nga grupi i përbashkët i punës. Ky dokument u miratua në Këshillin e Komunës Bushat në tetor 2012.



Raste për Nominim të Vendeve të Dekadës Rome

Çmimi për Kryebashkiakun më të mirë në çështjen Rome

Periudha e zbatimit: Korrik – Nëntor 2012

Donatori: Instituti për Shoqërinë e Hapur, Budapest

Fondi: 8,092 \$

Zbatuar në: Shqipëri

Zbatuar nga: Co-PLAN



Gjatë vitit 2012 Co-PAN u kontaktua nga Instituti i Shoqërisë së Hapur për të asistuar në dokumentimin e rasteve të angazhimit të Njësive të Qeverisjes Vendore në integrimin në shoqëri të komunitetit rom, si dhe të përmirësimit të kushteve të jetesës. Dokumentimi i rasteve u krye në bashkëpunim me Unionin e Romëve të Shqipërisë Amarodrom dhe u fokusua në pesë vitet e fundit. Puna kërkimore për dokumentimin e rasteve, dhe analiza u fokusua në qytetet që kanë dhe përqendrimin më të lartë të komunitetit rom, si: bashkitë e Elbasanit, Korçës, Beratit, Durrësit, Fushë - Krujës etj. Gjatë një aktiviteti të zhvilluar në muajin tetor në Budapest, Hungari, bashkitë patën mundësinë të prezantojnë rastet nga puna e tyre dhe të shkëmbejnë njohuri dhe eksperiencë në lidhje me mënyrat se si mund të rritet integrimi shoqëror dhe cilësia e jetesës së komunitetit rom.

Disa nga aktivitetet dhe rezultatet më të rëndësishme të vitit 2012 janë:

- > U identifikuan dhe u përzgjhën një numër bashkish që kanë komunitet rom në territorin e tyre dhe u kryen një numër konsultash me Unionin AmaroDrom.

- > Raste të evidentuara nga bashkitë e Fierit, Beratit, Korçës, dhe Elbasanit u dokumentuar dhe u përfaqësuan në aktivitetin final organizuar në Budapest, Hungari, ku u shkëmbyen eksperiencia nga puna e bashkive të pjesëmarrëse.





Publikime

Dy publikime të Rëndësishme në Planifikimin e Territorit

Politikëndjekës apo Politikëbërës 2!

Manual Fillestarësh për Advokim në Shqipëri

Praktika të Reja për Zhvillimin dhe Manaxhimin e Tokës në Shqipëri

Rigjallërimi i Shesheve të Qyteteve Ballkanike

Planifikimi i Manaxhimit Lokal të Mbetjeve



REVIVAL OF CITY SQUARE

Contribution to cultural and
livable city space

Planning Local Waste Management



POLITIKËNDJEKËS

APO

POLITIKËBËRËS 2!

Analiza dhe rekomandime për qeverisjen territoriale në Shqipëri

Politikëndjekës apo Politikëbërës 2!

Angazhimi dhe përkushtimi i vazhduar i Co-PLAN për ndikimin në politikëbërje fitoi një momentum të ri me publikimin e vëllimit të dytë të "Politikëndjekës apo Politikëbërës 2!". Duke ndërtuar në standartet e vendosura nga botimi i shkuar, në vitin 2010, dhe temat në thelb të ekspertizës dhe eksperiencës shumëvjeçare të Co-PLAN, ky vëllim analizash dhe rekomandimesh për qeverisjen territoriale në Shqipëri, sjell në vëmendje të lexuesit ekspert e qytetar çështje që kanë të bëjnë me politikat e administrimit të territorit dhe aspekte të lidhura ngushtë me zhvillimin urban, siç janë financat publike dhe manaxhimi mjedisor.

Të nëntë artikujt e prezantuar në këtë libër, janë hartuar mbi bazën e kërkimit shkencor dhe veç analizës nga pikëpamja e politikëbërjes, përmbajnë një analizë të mirëfilltë shkencore dhe shumë informative për Shqipërinë. Kjo e fundit synon t'i japë vërtetësi dhe baza solide mesazhit të çdo artikulli, ta vendosë atë në kontekstin evropian të zhvillimit dhe të mendimit profesional botëror, si edhe të sigurojë rekomandime që synojnë të përmirësojnë politikat publike shqiptare pa u politizuar ose pa u ndikuar nga interesa të njëanshëm të palëve.

Në linjë me angazhimin për të ndikuar në politikëbërje, Co-PLAN e ndau këtë botim me përfaqësues të qeverisë qendrore e vendore, partnerë, grupe interesi, si dhe me grupimet kryesore politike në vend. Kjo e fundit u vlerësua si veçanërisht e rëndësishme në periudhën parazgjedhore, duke ofruar propozime shumë konkrete për përmirësimin dhe fuqizimin e politikave në Shqipëri, në përputhje si me nevojat e brendshme të vendit, ashtu edhe me proceset për Integrimin Evropian.

POLITIKËNDJEKËS APO POLITIKËBËRËS 2!

Analiza dhe rekomandime për qeverisjen territoriale në Shqipëri


Editorë: Dritan Shutina dhe Rudina Toto

Vëllimi 2
Tiranë, 2012



Dy Publikime të Rëndësishme në Planifikimin e Territorit

Në kuadër të zbatimit sa më efektiv të Ligjit nr. 10119 'Për Planifikimin e Territorit', Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) e asistuar nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, me mbështetjen e Bankës Botërore, hartoi dhe publikoi dy manuale në mbështetje të autoriteteve vendore dhe të qytetarëve. "Manuali Teknik i Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit për Vendimmarrësit, Profesionistët dhe Zhvilluesit" u hartua përmes konsultave të vazhdueshme me grupet e interesit, dhe synon t'u vijë në ndihmë institucioneve qeverisëse në nivel qendror dhe vendor në zbatimin e ligjit të ri të planifikimit të territorit dhe instrumentet përkatëse, nëpërmjet 'zbërthimit teknik' dhe shembujve të aplikimit. "Udhëzuesi për Qytetarët - Planifikimi dhe Zhvillimi i Territorit në Shqipëri", gjithashtu i bazuar në konsulta me qytetarët, është i strukturuar në formën e pyetje-përgjigjeve dhe synon t'u vijë në ndihmë qytetarëve me nocionet dhe proceset bazë të ligjit të ri.



Praktika të Reja për Zhvillimin dhe Manaxhimin e Tokës në Shqipëri

Në kuadër të projektit “Promovimi i Partneriteteve për Qytetet e Përbashkëta”, një iniciativë e Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, Tiranë dhe IHS, Institutit për Strehim dhe Studime të Zhvillimit Urban, Rotterdam, u publikua libri me titullin “Praktika të reja për zhvillimin dhe manaxhimin e tokës në Shqipëri”. Projekti në fjalë është mbështetur nga qeveria holandeze përmes programit MATRA. Ashtu si dhe projekti, libri synon ngritjen e kapaciteteve të institucioneve publike si dhe profesionistëve të fushës për një qeverisje më të mirë.

Ky botim është në vazhdim të përpjekjeve që Co-PLAN bën për zbatimin e ligjit nr. 10119 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar së fundmi. Libri në fjalë është i bazuar në pesë raste studimore, të cilët shtrihen në tri nga bashkitë e mëdha të vendit, Durrësit, Fierit dhe Shkodrës. Puna në bashki është fokusuar kryesisht në hartimin e këtyre rasteve studimore të mundësië së zbatimit të instrumenteve të reja të manaxhimit të tokës me anën e të cilave do të mundësohet balancimi i interesave publike dhe private në zhvillim, duke inkurajuar forcimin e demokracisë dhe rolin e ligjit në zhvillimin e tokës në Shqipëri.

Përmes rasteve studimore, ky botim mundohet që të evidentojë nevojën që ka Shqipëria për tranzitimin nga zhvillim i tokës në bazë parcele (apo 3-4 parcelash) në një zhvillim territorial, që merr parasysh kontekstin përreth dhe një hapësirë më të madhe, në bazë zone. Ky zhvillim në bazë zone, përveç ndikimit në anën fizike/hapësinore të strukturave apo hapësirave përreth, merr parasyh edhe kostot e sigurimit të infrastrukturës publike në mjedis dhe ndryshimin e vlerës së pronave, si pasojë e zhvillimit në zonë.

Libri “Praktika të Reja për Zhvillimin dhe Manaxhimin e Tokës në Shqipëri”, duke marrë parasysh vështirësitë e hasura përgjatë punës për hartimin e rasteve studimore dhe jep disa përfundime dhe rekomandime që duhen të merren parasysh si nga autoritetet vendimarrëse, por edhe nga zhvilluesit dhe profesionistët, si aktorë të rëndësishëm në zhvillimin dhe kontrollin e territorit në Shqipëri. Rekomandimet shprehin, gjithashtu, rëndësinë e hapave që duhen marrë nga aktorët në fjalë, me qëllim mundësimin e zbatimit të instrumenteve të manaxhimit të tokës, që baza ligjore për planifikimin dhe zhvillimin e tokës mundëson sot për territorin e Shqipërisë.

PRAKTIKA TË REJA PËR ZHVILLIMIN DHE MANAXHIMIN E TOKËS NË SHQIPËRI


Editorë:
Zenel Bajrami
Rudina Toto
Tiranë, 2013

Planifikimi i Manaxhimit Lokal të Mbetjeve

Ky është një udhëzues praktik për NjQV-të për të ushtruar përgjegjësinë e tyre për çështjet e manaxhimit vendor të mbetjeve. Objektivi kryesor i këtij manuali është të ofrojë një udhëzues të plotë dhe efektiv për njësitë e pushtetit vendor, që kanë për qëllim ose janë duke zhvilluar një plan lokal për manaxhimin e mbetjeve, dhe përfshin hartimin, zbatimin dhe procesin e monitorimit të vetë planit. Për më

tepër, ky manual mund të shërbejë si një instrument ndihmës për NjQV-të që dëshirojnë të analizojnë gjendjen ekzistuese të manaxhimit të mbetjeve, të identifikojnë dhe të vlerësojnë opsionet, metodologjitë dhe skenarët, të përcaktojnë kostot dhe nevojat financiare, të hartojnë rregulloret dhe të organizojnë këto shërbime nga faza e parë e gjenerimit të tyre deri te depozitimi final i tyre.

Gjithashtu, manuali shërben për të nxjerrë në pah dhe për të promovuar ide dhe praktika të mira vendore, që kanë lindur dhe janë zhvilluar gjatë seancave të trajnimit dhe këshillimit me NjQV-të, kryesisht në qarkun e Shkodrës dhe të Lezhës. Këto praktika janë përdorur për të ilustruar hapat dhe aspektet teknike e udhëzuese të këtij manuali dhe për të nxitur nisma të tjera të ngjashme në rajon apo më gjerë.




Rigjallërimi i Shesheve të Qyteteve Ballkanike

Publikimi 'Rigjallërimi i Shesheve të Qyteteve Ballkanike' prezantoi eksperiencën e projektit me të njëjtin emër, duke dokumentuar kështu qasjet dhe rezultatet e aktiviteteve të ndërmarra me qëllim rigjallërimit të hapësirave publike përgjatë një harku kohor prej 2 vjetësh në qytetet e Tiranës, Durrësit (Shqipëri), Kotorr (Mali i Zi), dhe Shkup (Maqedoni).

I konceptuar si një kronikë për të dokumentuar procesin e bërjes dhe ndarjes së njohurisë dhe eksperiencave të përfuara nga zbatimi i projektit, ky publikim vjen si një përmbledhje e projektit, i organizuar në katër pjesë kryesore, secila dedikuar një fushe kërkimore të veçantë.

Fillimisht, ofrohet një shpjegim se si perceptohet hapësira publike nga aktorët e përfshirë; adresohet çështja e pjesëmarrjes së komunitetit dhe grupeve të interesit në vendim-marrje në lidhje me hapësirat publike; së fundmi, publikimi ndalet në rastin e secilit qytet dhe aktivitetet e zhvilluara përgjatë zbatimit të projektit, si dhe zhvillimet e konferencës së mbajtur me të njëjtën temë, kryesisht nga një anë teorike.

Publikimi vjen si një koleksion historish të shkurtra nga ndodhitë, eksperiencat dhe performancat e kryera në një numër hapësirash publike në qytetet e Tiranës, Durrësit, Kotorrit dhe Shkupit.



Manual fillestarësh për Advokim në Shqipëri

Mos e vër kurrë në dyshim që një grup i vogël qytetarësh të kujdesshëm e të angazhuar mund ta ndryshojë botën. Në fakt, është e vetmja gjë që ka mundësuar ndryshimin.

-Margaret Mead

“Udhëzuesi i Advokimit për Fillestarë në Shqipëri” është një manual praktik mbi iniciativat e advokimit në politikat publike, hartuar nga ekspertë të fushës në Co-PLAN. Ky udhëzues i drejtohet një audience të gjerë përfshirë *think tanke*, institute kërkimore, OJF, akademikë, shoqata, koalicione apo grupe interesi, por edhe individë, analistë politikë dhe këshilltarë të qeverisë. Pra, çdo individ apo organizatë që dëshiron të ndikojë në procesin e politikëbërjes në Shqipëri, mund ta përdorë këtë udhëzues si një hap fillestar drejt ngritjes së një çështjeje për debat publik, ndikimit të një politike aktuale apo drejt bashkimit të forcave me grupe të tjera për të sjellë ndryshim në fushën e tyre të interesit. Gjithshtu, ky udhëzues përbën edhe një hyrje praktike dhe koncize në proceset komplekse të krijimit dhe implementimit të politikave publike në Shqipëri dhe mënyrat se si advokimi mund të përdoret për të ndikuar në to. Materiali është i organizuar në katër kapituj ku mbulohen koncepte të advokimit edhe në arenën e politikave publike, llojet e ndryshme të politikave publike dhe modelet e ndryshme të advokimit që i përshtaten secilit lloj. Udhëzuesi fokusohet te politikëbërja në Shqipëri dhe shpjegon proceset e saj, si nga konteksti institucional (ekzekutiv dhe legjislativ) ashtu edhe nga konteksti i shoqërisë civile, dhe ofron në çdo rast shembuj dhe raste studimore. Skenarë dhe qasje të ndryshme ilustrohen me iniciativa nga arenat Shqiptare dhe nërkombëtare të politikëbërjes, për tu ofruar lexuesve një përshkrim të përpjekjeve që zakonisht nevojiten për të arritur ndikimin e politikave.

Shpresojmë që *think tanke*, organizata të shoqërisë civile, qendra kërkimore si dhe individë e grupe vullnetare do të mund ta përdorin këtë udhëzues si një hap fillestar në advokimin në politikë. Nëpërmjet përpjekjeve për të ushtruar ndikim në politikëbërje, advokatët u shërbejnë gjithashtu interesave të tyre duke ndihmuar njëkohësisht përfshirjen aktive të shoqërisë civile shqiptare në vendimet që rregullojnë jetën publike. “Udhëzuesi i Advokimit për Fillestarë në Shqipëri” është i pari në një sërë iniciativash dhe publikimesh nga Co-PLAN, për të ndjekur këtë objektiv dhe për të kontribuar në një mjedis më demokratik dhe më përfshirës në politikëbërjen shqiptare.

